



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 703 Akti

Nr. 796 Vendimi
Tiranë, më 4.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Roland Ilia Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 4.9.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Xhevahir Lita**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjo i përfaqësuesin e subjektit të rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, si dhe pasi shqyrtoi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita,

VËREN SE:

1. Subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita, në periudhën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
3. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ligjzbatuese.
5. Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues kanë deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
6. Bazuar në praktikën e administruar dhe gjetjet, relatori i çështjes, pasi ka administruar të tria raportet e rivlerësimit, propozoi mbylljen e hetimit administrativ bazuar në kriterin e rivlerësimit të figurës, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pas përfundimit të hetimit administrativ për kriterin e rivlerësimit të kontrollit të figurës, në datën 30.5.2024 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për këtë kriter për subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, njoftimin se deri në datën 10.6.2024 subjekti i rivlerësimit mund të njihet me dosjen, si dhe me kalimin e barrës së provës ka të drejtën për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
8. Por, Komisioni, bazuar në kërkesën¹ e avokatit të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, z. A. N, për zgjatjen e afatit të procedurës për një afat 20-ditor, vendosi² pranimin e kësaj kërkesë,

¹ Shihni kërkesën nr. **** prot., datë 10.6.2024, të av. A. N.

² Shihni vendimin e Komisionit nr. ***, datë 11.6.2024.

duke i dhënë të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, duke i caktuar datën 1.7.2024 për paraqitjen e provave/shpjegimeve në lidhje me rezultatet e hetimit. Me gjithë këtë shtyrje të afatit të dorëzimit të shpjegimeve përfundimtare nga ana e Komisionit, ato përsëri nuk u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar më sipër, duke i rikërkuar paraqitjen e shpjegimeve brenda datës 11.7.2024.

9. Ndërsa në përgjigje të kërkesës³ së datës 10.7.2024 të av. A. N, me objekt “Çeljen e hetimit administrativ edhe sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale”, Komisioni e refuzoi këtë kërkesë dhe e ftoi subjektin për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore në datën 4.9.2024, ora 10:00.

10. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Xhevahir Lita në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

Faktet dhe rrethanat lidhur me çështjen

11. Subjekti i rivlerësimit Xhevahir Lita, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka qenë duke ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

12. Me vendimin nr. ***, datë 31.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori Xhevahir Lita është pezulluar nga detyra deri në rënien e shkakut për të cilin është vendosur. Ky vendim i KLP-së është bazuar në nenin 151, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

14. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita.

15. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2023, Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të figurës së subjektit Xhevahir Lita.

16. AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2023, ka dërguar raportin e Grupit të Punës nr. ***, datë 14.11.2023. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 16.11.2023.

17. AKSIK-ja në raportin e saj ka konstatuar se:

- Gjatë periudhës në të cilën z. Xhevahir Lita ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive.
- Në lidhje me subjektin në fjalë, jemi informuar edhe mbi të dhënat që disponohen për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

³ Shihni kërkesën e av. A. N të datës 10.7.2024, protokolluar pranë Komisionit në datën 11.7.2024.

- SPAK dhe Agjencia për Mbikëqyrjen Policore kanë përcjellë të dhëna të reja që dispononin për subjektin e rivlerësimit.
- Nga institucionet e sipërcituara na bëhet me dije se ndaj z. Xhevahir Lita është caktuar masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”.
- Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, arsyetohet të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme në format e korrupsionit gjatë ushtrimit të detyrës, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.
- Situata pasqyron korrupsionin sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë disponohen informacione për përfshirje në veprime korruptive të një prokurori. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.
- Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin tonë të një prokurori, në periudha të shkëputura kohe e, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të shkronjave “b” e “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
- Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për atë vetë si funksionar publik apo të personave të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësojmë se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.
- Mbështetur në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese, merret në konsideratë fakti se është informuar Presidenti i Republikës dhe ndaj subjektit Xhevahir Lita është vendosur masa e sigurisë “Arrest në burg”.
- Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Xhevahir H Lita.

Hetimi i Komisionit

18. Komisioni kreu një hetim të plotë dhe gjithanshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës, si dhe etikën (çështje të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën) për subjektin e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016.

19. Nisur nga të dhënat dhe praktika e administruar, Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2023, i kërkoi Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kopje të vendimeve të dhëna nga kjo Gjykatë ndaj subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita.

20. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vuri në dispozicion 2 vendime gjyqësore, përkatësisht:

- vendimin penal nr. ***, datë 23.7.2023, me objekt “Caktim mase sigurie ndaj shtetasit Xhevahir Lita”;
- vendimin penal nr. ***, datë 29.7.2023, me objekt “Ekzekutim mase sigurimi ndaj shtetasit Xhevahir Lita”.

21. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2024, Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) të vërë në dispozicion kopje të vendimeve për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe çdo dokumentacion tjetër shkresor që mund të shërbejë për procesin e vlerësimit të figurës për subjektin Xhevahir Lita.

22. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024, SPAK dërgoi pranë Komisionit informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita.

23. Në vlerësimin e tij për këtë çështje lidhur me kriterin e figurës dhe etikën e subjektit të rivlerësimit, Komisioni mban në konsideratë:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kodin Penal;
- Ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Parimet e Bangalorit mbi sjelljen gjyqësore, të miratuara nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002);
- Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me figurën dhe kontaktet e papërshtatshme

24. Kontrolli i figurës për subjektet e rivlerësimit për kontakte të papërshtatshme, si dhe lidhjen e tyre me persona të përfshirë në krimin e organizuar, bazohet në deklaratën për figurën, raportin e organeve të tjera ndihmëse, provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.

25. Komisioni gjatë hetimit administrativ ka administruar vendimin penal nr. ***, datë 23.7.2023, të GJKKO-së, ku është vendosur *Caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për subjektin e rivlerësimit nën hetim, z. Xhevahir Lita.*

26. Bazuar në këtë vendim të GJKKO-së, rezultoi se:

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka kërkuar pranë GJKKO-së caktimin e masës së sigurimit personal të karakterit shtrëngues “Arrest në burg” për subjektin Xhevahir Lita, i dyshuar për veprat penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dy herë dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga nenet 319/ç e 333/a të Kodit Penal.
- Hetimi i prokurorisë është bazuar në komunikimet e kryera në aplikacionin SkyECC. Ky aplikacion, SkyECC *****, është poseduar dhe përdorur nga shtetasi Xhevahir Lita, i datëlindjes 8.3.1973.
- **Çështja 1.** Shtetasi P.Gj. kontakton me prokurorin Xhevahir Lita, ku vazhdimisht interesohet dhe ofron shuma parash në këmbim të zbutjes së masës së sigurimit të shtetasit B. B. Prokurori Lita pas kontaktit me shtetasin P. Gj. ka ndërmarrë veprime aktive, duke përdorur kompetencat që i ka dhënë ligji, duke ndikuar dhe krijuar të gjitha mundësitë për lirim të shtetasit B. B. dhe më pas ndryshuar edhe akuzat, duke i zbutur ato. Në datën 30.6.2020, z. Xhevahir Lita kontakton drejtpërdrejt me shtetasin B. B., identifikuar si posedues dhe përdorues i aplikacionit SkyECC@***** dhe SkyECC@*****⁴.
- **Çështja 2.** Lidhur me ngjarjen e datës 21.2.2021 për vrasjen e mbetur në tentativë të shtetasit T. P. Shtetasit E. H., B. M. dhe A. B. në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë dhënë një shumë parash prokurorit Xhevahir Lita, me qëllim devijimin e hetimeve dhe shmangien e ndjekjes penale për autorët. Xhevahir Lita, me funksion prokuror, pasi ka rënë dakord për shumën e parave, ka ndihmuar duke dhënë informacione lidhur me veprimet hetimore që po kryhen, ka dhënë orientime se si dhe çfarë duhet të deklarojnë në policinë gjyqësore, si dhe nuk ka kryer veprime të tjera që mund të çonin në identifikimin e autorëve, ka shmangur nga ndjekja penale shtetasit E. H. dhe A. B., duke akuzuar si autor të ngjarjes shtetasin Sh. Xh., për të cilin ka lehtësuar akuzat penale⁵. Prokurori Xhevahir Lita, si prokuror i çështjes, jep orientime, bashkëpunon dhe ndihmon në disponimin e akteve, krijon dyshime të arsyeshme lidhur me objektivitetin dhe paanshmërinë në hetimet e kryera në rastet për të kallëzuarit, personat nën hetim, apo të afërt dhe lidhjet shoqërore të tyre.
- Duke pasur parasysh veprimet e prokurorit Xhevahir Lita, ku bashkëvepron me shtetasit P. Gj. dhe B. B., apo në rastin kur shtetasi B. B. i ndërhyr për një procedim penal në emër të personit G. V., ku subjekti pranon t'i gjejë një zgjidhje për procedim sipas kërkesës së shtetasit B. B., si dhe duke vlerësuar rastin kur subjekti kontaktohet për shmangie nga përgjegjësia penale të shtetasve E. H. dhe A. B., gatishmëria për t'i ndihmuar dhe liria në komunikim me to krijon dyshime të arsyeshme se prokurori Xhevahir Lita bashkëpunon me këta shtetas jo thjesht si lidhje shoqërore apo kontakt i rastësishëm, por në formën e një grupi të strukturuar kriminal, ku ai shfrytëzon dhe përdor me dashje kompetencat e dhëna nga ligji për t'i dhënë mbrojtje penale këtyre personave.

27. Bazuar në vendimin penal nr. ***, datë 29.7.2023, rezultoi se GJKKO-ja ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

⁴ Për më tepër referojuni vendimit nr. *** të GJKKO-së, faqet 67-92.

⁵ Për më tepër referojuni vendimit nr. *** të GJKKO-së, faqet 92-111.

Krimin e Organizuar me vendimin nr. ***, datë 23.7.2023, për personin nën hetim, prokurorin Xhevahir Lita.

- Në vendimin e saj, kjo gjykatë konstaton se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, që personi nën hetim Xhevahir Lita, me detyrë prokuror, në këmbim të përfitimit të paligjshëm të shumave monetare me qëllim zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasit B. B., duke mos vlerësuar objektivisht, ka konsumuar elemente të veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Dyshohet se si pasojë e veprimeve të prokurorit Xhevahir Lita, është bërë i mundur lirimi i shtetasit B. B., i cili pas daljes nga paraburgimi dyshohet se ka kryer vrasjen e shtetasit Gj. N.
- Personat nën hetim P. Gj. dhe B. B., me veprime aktive të kryera me dashje, duke i dhënë dhe ofruar shuma monetare prokurorit Xhevahir Lita për të mos kryer apo kryer detyrën e tij funksionale me qëllim ndryshimin e masës së sigurimit të shtetasit B. B., kanë cenuar funksionimin e drejtë dhe të ndershëm të sistemit të drejtësisë.
- Prokurori Xhevahir Lita, që ka drejtuar dhe kryer hetime në procedimin penal nr. ***, ***, ka kërkuar dhe ka marrë një përfitim të parregullt nga shtetasit E. H., A. B. dhe B. M., me qëllim që të lehtësonte pozitën procedurale apo të shmangte nga ndjekja penale shtetasit E.H. dhe A. B. Prokurori Xhevahir Lita dyshohet se ka konsumuar elemente të veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”.
- Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se prokurori Xhevahir Lita jep orientime, bashkëpunon dhe ndihmon në disponimin e akteve, krijon dyshime të arsyeshme lidhur me objektivitetin dhe paanshmërinë në hetimet e kryera në rastet për të kallëzuarit apo personat nën hetim. Prokurori Xhevahir Lita krijon dyshime të arsyeshme se bashkëpunon me shtetasit e lartpërmendur jo thjesht si lidhje shoqërore apo kontakt i rastësishëm, por në formën e një grupi të strukturuar kriminal, ku vetë ai dyshohet se shfrytëzon dhe keqpërdor me dashje kompetencat e dhëna nga ligji për të dhënë mbrojtje për personat nën hetim apo personat e lidhur me ta.

28. Bazuar në informacionin e dërguar nga SPAK me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2024, rezultoi se:

- Nga aktet e këtij procedimi rezulton se agjencitë ligjzbatuese evropiane kanë përcjellë informacione për disa shtetas shqiptarë, përdorues të platformës së komunikimit të enkriptuar SkyECC dhe dyshohen si të përfshirë në aktivitet kriminal në fushën e krimeve kundër jetës, trafikimit të lëndëve narkotike të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal, falsifikimit të dokumenteve dhe shpërdorimit të detyrës e korrupsionit nga funksionarë publikë. Këta përdorues kanë koordinuar me njëri-tjetrin nëpërmjet komunikimeve të enkriptuara në aplikacionin SkyECC.
- Në datën 18.7.2023, në regjistrin e njoftimit të veprave penale në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është regjistruar emri si person nën hetim për shtetasit Xhevahir H Lita, P. Gj., B. B., B. M., E. H., A. B. etj.
- Nga hetimet paraprake të zhvilluara në kuadër të këtij procedimi, ka dyshime se personi nën hetim Xhevahir Lita dyshohet të ketë qenë posedues dhe përdorues i aplikacionit SkyECC, me anë të të cilit ka mbajtur kontakte me përdorues të tjerë të këtij aplikacioni, të

identifikuar si B. B., P. Gj. dhe B. M. Nga analizimi i bisedave të përdoruesit të aplikacionit SkyECC, i dyshuar si Xhevahir Lita, janë evidentuar të dhëna lidhur me dy episode të ndryshme, si vijon:

1. Ndryshimi i masës së sigurimit të shtetasit B. B.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 14.2.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit B. B. etj., për veprat penale “Vrasja me dashje, e mbetur në tentativë”, “Vrasja me dashje”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, “Organizimi i lotarive të palejuara”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, “Mashtrimi” në bashkëpunim, “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Shpërdorimi i detyrës”, vepra këto të parashikuara nga nenet 76-25-22, 76-25, 278/2, 197, 287/a, 109/b, 143/2, 135 dhe 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Me vendim për caktimin e grupit hetimor datë 17.2.2020, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Shkodër ka shtuar një prokuror në hetim, duke vendosur që procedimi penal nr. ***/*** të hetohet dhe përfaqësohet në gjykim nga prokurorët E. C. dhe Xhevahir Lita.
- Shtetasi B. B., i cili ndodhej i paraburgosur në IEVP-në “****”, T, nëpërmjet aplikacionit SkyECC@***** (përdoret, por nuk është në posedim të tij) komunikon me shtetasin P. Gj., i identifikuar si posedues dhe përdorues i SkyECC@***** dhe interesohet që të dalë sa më shpejt nga paraburgimi, duke ofruar shuma parash në këmbim.
- Shtetasi P. Gj. kontakton me prokurorin e çështjes Xhevahir Lita, i identifikuar si posedues dhe përdorues i aplikacionit SkyECC@***** dhe vazhdimisht interesohet dhe ofron shuma parash në këmbim të zbutjes së masës së sigurimit të shtetasit B. B., të cilit në biseda me prokurorin Xhevahir Lita i referohet me pseudonime, veprime këto të koordinuara me shtetasin B. B.
- Xhevahir Lita, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi është kontaktuar nga shtetasi P. Gj., ka ndërmarrë veprime aktive, duke keqpërdorur kompetencat që i ka dhënë ligji, duke ndikuar dhe krijuar të gjitha mundësitë për lirimin e shtetasit B. B., në datën 29.6.2020 dhe më pas ndryshuar edhe akuzat, duke i zbutur ato.
- Me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shtetasit B. B. i është ndryshuar masa e sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Pas kësaj date, më 30.6.2020, Xhevahir Lita kontakton drejtpërdrejt me shtetasin B. B., i identifikuar si posedues dhe përdorues i aplikacionit SkyECC*****.

2. Vrasja e mbetur në tentativë e shtetasit T. P., në datën 21.2.2021

- Në datën 21.2.2021, rreth orës 11:45, në lagjen “****”, Bashkia Shkodër, në një pikë të shitjes së karburantit me shumicë përballë *** Shkodër, tre persona të cilët udhëtonin me automjetet me targa ***** dhe *****, në bashkëpunim kanë qëlluar me armë zjarri pistoletë ndaj shtetasve T. P. dhe K. M., të cilët ndodheshin në automjetin tip “****”, ngjyrë e bardhë.
- Lidhur me këtë fakt, po këtë ditë, pas referimit të oficerëve të policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, L. H. dhe E. M., prokurori Xhevahir Lita ka

regjistruar procedimin penal nr.*** për veprat penale “Vrasja me paramendim”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 78-22-25 dhe 278/1 të Kodit Penal. Persona të dyshuar nga policia gjyqësore ishin shtetasit E. H., Sh. Xh., A. B. dhe B. Z.

- Pas fillimit të hetimeve paraprake, shtetasi E. H., i identifikuar si përdorues i aplikacionit SkyECC@*****, shtetasi B. M., i identifikuar si përdorues i aplikacionit SkyECC@***** dhe shtetasi A. B., i identifikuar si përdorues i aplikacionit SkyECC@***** në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë dhënë një shumë parash prokurorit Xhevahir Lita, i identifikuar si përdorues i aplikacionit SkyECC@*****, me qëllim devijimin e hetimeve dhe shmangien e ndjekjes penale për autorët. Shuma e parave është siguruar nga E. H. dhe B. M., i cili ka diskutuar paraprakisht me prokurorin Xhevahir Lita lidhur me shumën, e cila i është dorëzuar nga shtetasi A. B. në Tiranë.
- Xhevahir Lita, me funksion prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka rënë dakord për shumën e parave, ka ndihmuar duke i dhënë informacione lidhur me veprimet hetimore që po kryhen, ka dhënë orientimet se si dhe çfarë duhet të deklarojnë në policinë gjyqësore, si dhe nuk ka kryer veprime të tjera që mund të çonin në identifikimin e autorëve, ka shmangur nga ndjekja penale shtetasit E. H. dhe A. B., duke akuzuar si autor të ngjarjes shtetasin Sh. Xh., për të cilin ka lehtësuar akuzat penale, për të cilat është regjistruar procedimi penal duke akuzuar për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Kanosja”, të parashikuara nga nenet 278/1 dhe 84 të Kodit Penal dhe më pas është dërguar për gjyq.

29. Lidhur me episodet e sipërpërmendura, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. ***, datë 23.7.2023, ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, ndër të tjerë, edhe për personin nën hetim Xhevahir Lita, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, dy herë dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 333/a të Kodit Penal.

30. Rezultoi se vendimi nr. ***, datë 23.7.2023, është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. ***, datë 31.8.2023.

31. Vendimi i Gjykatës është ekzekutuar nga policia gjyqësore në datën 27.7.2023 dhe që prej ekzekutimit të vendimit z. Xhevahir Lita ndodhet i paraburgosur në ambientet e IEVP-së D.

32. Me shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 8.4.2024, iu kërkua Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Lartë kopje të 2 vendimeve gjyqësore, si vijon:

32.1 Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2024, ka kthyer përgjigje dhe ka dërguar një kopje të vendimit gjyqësor të kësaj Gjykate me nr. *** (***), datë 19.9.2023.

32.2 Gjykata e Lartë me shkresën nr. *** prot., datë 11.4.2024, vuri në dispozicion vendimin nr. *** (***), datë 22.12.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Bazuar në këtë vendim, rezultoi se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të hetuarit P. Gj., E. P., A. H. dhe subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita, është lënë në fuqi.

33. Në pjesën arsyetuese të vendimit, Gjykata e Lartë⁶ lidhur me vlefshmërinë e provave të marra në këtë proces (mesazhet nëpërmjet SkyECC), ndër të tjera, është shprehur:

1. Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është mjaftueshëm i arsyetuar dhe në respektim të standardit provues të kërkuar në këtë fazë të procedimit, të përcaktuar edhe në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 07/2011. Pretendimet e personave nën hetim P. Gj., E. P., A. H., Xhevahir Lita për ligjshmërinë dhe përdorshmërinë e provës mesazhe “chat” në SkyECC, kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit, arsyetim të cilin ky Kolegj e gjen të drejtë dhe e mbështet në të gjitha argumentet e tij.

2. Në të vërtetë, mbi llojin e provës dokument, në të cilën kuadratohej mesazhet chat në SkyECC dhe përdorshmërinë e tyre, ka një jurisprudencë të pasur të gjykatave të vendeve të Bashkimit Europian, të cilave kjo Gjykatë e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i referohet dhe ndan të njëjtat argumente, sepse rasti në shqyrtim është i ngjashëm me rastet e shqyrtuara nga ato gjykata.

3. Provat e marra janë tërësisht të përdorshme edhe nën të tillë profil. Specifikisht, provat nuk i janë kërkuar një mbajtësi privat (për shembull S.G që administronte para sekuestrimit nga ana e policisë gjyqësore të huaj, platformën e cila diskutohet), por autoriteteve gjyqësore që i ka marrë provat dhe dërguar në formën e dokumentit, nëpërmjet ekzekutimit të letërporosisë, autoriteteve gjyqësore shqiptare. Në konsideratë të zbatimit të normave procedurale, duket e përshatshme të verifikohet, në përputhje me normat procedurale penale të brendshme, ligjshmëria e marrjes së provave nga autoritetet gjyqësore që i kanë transmetuar ato. Dhe përgjigja nuk mundet veçse të jetë pozitive, gjithmonë në kufijtë e shqyrtimit të koherencës/qëndrueshmërisë me parimet themelore të sistemit tonë, sepse veprimtaria e marrjes së provave është zhvilluar nën drejtimin e një gjyqtari (të Gjykatës së Parisit), në përputhje të plotë edhe me sa parashikon neni 151 i Kodit të Procedurës Penale, në kombinim me sa parashikohet në dispozitat e seksionit VIII “dokumentet” të Kodit të Procedurës Penale.

4. Po ashtu, parë edhe në vështrim të nenit 191/a të Kodit të Procedurës Penale, si të dhëna të memorizuara mbi një mjet memorizimi, chat të SkyECC, përbëjnë prova dokument, që edhe sipas legjislacionit të brendshëm dhënësi i shërbimit të ofruar është i detyruar të dorëzojë çdo informacion për abonentët e abonuar (neni 191/a i Kodit të Procedurës Penale), kur urdhërohet apo vlerësohet nga Gjykata.

5. Si përfundim, pikërisht në temë të mesazheve të shkëmbyera me sistemin e koduar “SkyECC” dhe “ENCROCHAT”, është pohuar edhe nga jurisprudenca ndërkombëtare që dekriptimi i bisedave dhe komunikimeve është veprimtari e dallueshme nga kapja/marrja, të tilla të dhëna që përbëjnë përfaqësime komunikuese të inkorporuara në një bazë materiale me një metodë digjitale, domethënë të dhëna informatike që kanë lejuar kuptueshmërinë e përmbajtjes së vargjeve të shkruara sipas sistemit binar.

6. Në kuadër të trajtimit të shkaqeve pretenduese në lidhje me përdorshmërinë e provave të marra nëpërmjet letërporosisë, si një nga format e ndihmës juridike, Kolegji sjell në vëmendje se shteti shqiptar, me ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999, ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe protokollin e saj shtesë (në vijim Konventa). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se Prokuroria e Posaçme ka vepruar

⁶ Shihni të plotë pjesën arsyetuese të vendimin nr. *** (***), datë 22.12.2023, të Gjykatës së Lartë.

*brenda sferës dhe kompetencës që i jep neni 1 i Konventës, që parashikon bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese. Kështu, sikurse evidentohet edhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit, autoritetet gjyqësore shqiptare i kanë kërkuar autoriteteve gjyqësore franceze, me letërporosi, marrjen e provave të administruara nga autoritetet e drejtësisë franceze gjatë procedimit penal, të quajtur prej tyre “***”, letërporosi e pranuar nga autoritetet gjyqësore franceze dhe, që në ekzekutim të saj (letërporosisë), provat janë marrë duke proceduar në përputhje me normat procedurale penale të parashikuara nga neni 3, paragrafi 1 i Konventës, si dhe neni 509 i Kodit të Procedurës Penale. Sikundër ka evidentuar Gjykata e Posaçme e Apelit në letërporosinë e dërguar shtetit të huaj, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar autoriteteve gjyqësore franceze marrjen e provave dokument, të cilat posedoheshin nga shteti i kërkuar që i kishte marrë me iniciativë të vet gjatë procedimeve penale të varura në atë vend.*

7. Kolegji sjell në vëmendje se neni 10/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi”. Bazuar në nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale (si normë e brendshme referuese), parashikohet e drejta për të proceduar me marrjen e provave në një shtet tjetër, letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrja e provave i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t’i nisur ato.

Për më tepër, lidhur me këtë çështje, referojuni pikave 93-112 të vendimit të Gjykatës së Lartë nr. *** (***), datë 22.12.2023.

Në lidhje me etikën

34. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror, por edhe jashtë ushtrimit të funksionit, duhet të udhëhiqet nga rregullat dhe standardet e sjelljes, të sanksionuara këto me akte ligjore, nënligjore dhe kode etike të adoptuara.

35. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit përbëhen nga tërësia e primeve, normave dhe rregullave gjerësisht të pranueshme, të cilat udhëheqin sjelljen e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, gjatë kryerjes së veprimtarisë jashtë funksionit, si dhe në jetën private.

36. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit synojnë të vendosin, ruajnë dhe forcojnë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisin efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Këto rregulla përkrahin zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe profesionale, ruajtjen e imazhit të profesionistit, si dhe sjelljen e përshtatshme në zyrë, në prokurori, në gjykatë apo jashtë këtyre ambienteve, për shkak të funksionit si prokuror.

37. Prokurori duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes etike dhe profesionale si dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e tij të ruhen si dhe të parandalohen shkeljet e ligjit.

38. Prokurori sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e prokurorisë. Sjellja dhe qëndrimi i prokurorit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek sistemi i prokurorisë.

39. Sipas këtyre parimeve, prokurori:

- kujdeset për ruajtjen e pastërtisë së figurës si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi i prokurorisë;
- sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e publikut;
- shmang çdo përfitim personal për vete, familjarë apo të tjerë, që i vijnë për shkak të detyrës si prokuror, dhe nuk lejon me vetëdije që të tjerët të japin përshtypjen se kanë një pozicion të veçantë për të pasur ndikim të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së prokurorit;
- nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial për të cilin prokurori vihet në dijeni për shkak të detyrës, apo ta zbulojë atë për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet me ushtrimin e detyrës;
- prokurori duhet të ketë kujdes që të mos bëhet shkak që publiku ta lidhë me një organizatë, grup apo kauzë të veçantë.

40. Në Komentarin e Parimeve të Bangalores për “Sjelljen Gjyqësore” është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore, duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanshmërisë dhe reputacionit, ndër të tjera.

41. Sjellja e prokurorëve jo vetëm në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Prokurori duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes etike dhe profesionale, si dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e tij të ruhen dhe të parandalohen shkeljet e ligjit. Sjellja e prokurorëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Referuar Parimeve të Bangalores, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Referuar “teorisë së dukjes”, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim, vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një magjistrat në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të magjistratit konsiderohen si cenim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia dhe/ose diskretitojnë pozitën dhe figurën e magjistratit.

42. Neni 10 i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” lidhur me çështjen e etikës parashikon se: *“Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës”*.

43. Neni 3, ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton vlerat themelore që duhet të ketë një individ, që ushtron funksionet e magjistratit. Sipas kësaj dispozite, një magjistrat (prokuror) duhet të demonstrojë vlerat personale bazuar në vetëdijen që sjellja e një magjistrati ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut. Në kuadër të parashtrimit të vlerave themelore, kjo dispozitë parashtron

edhe disa standarde të sjelljes dhe mënyrën si një magjistrat duhet të ushtrojë funksionin, rregulla që vlejné si gjatë ushtrimit të funksionit edhe jashtë tij.

44. Në kuadrin e forcimit të besimit të publikut, paragrafi 5 i nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendos disa rregulla orientuese dhe detyruese për sjelljen e magjistratit në ushtrimin e funksionit. Ndër të tjera, përcaktohet edhe se funksioni i magjistratit duhet të ushtrohet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vetëdije për rëndësinë e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive që i janë ngarkuar me ligj, si dhe për pasojat që çdo sjellje e tij ka tek sistemi i prokurorisë, por edhe tek zhvillimi i shoqërisë në tërësi. Po kështu, neni 4, pika 2, shkronja “b” e ligjit të sipërcituar, përcakton se: *“Magjistrati duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin apo me vetë etikën, si dhe duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor”*.

45. Parimi i respektimit të rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale duket se është një nga parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë.

46. Trupi gjykues vendosi dërgimin e rezultateve të hetimit subjektiv të rivlerësimit, referuar gjetjeve të mësipërme.

47. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektiv të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit.

Qëndrimi i përfaqësuesit të subjektiv të rivlerësimit⁷

- Në përgjigje të rezultateve të hetimit, përfaqësuesi i subjektiv të rivlerësimit, av. A.N, ka parashtruar para Komisionit se përfundimet e arritura nga Komisioni janë pjesë e hetimit penal të kryer ndaj subjektiv të rivlerësimit Xhevahir Lita dhe se në rastin konkret cenojné një ndër elementet përcaktuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, siç është ai i prezumimit të pafajësisë.
- Parimi i prezumimit të pafajësisë ka vlerë kushtetuese, pasi parashikohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”*, por edhe ligjore, sepse sanksionohet në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale, me këtë përmbajtje: *“I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”*.
- Edhe KEDNJ-ja në paragrafin e dytë të nenit 6 të saj *“E drejta për një proces të rregullt”* e përkufizon kështu parimin e prezumimit të pafajësisë: *“Çdo person i akuzuar për kryerjen e një vepre penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk është vendosur ligjërisht”*. Kjo e drejtë themelore e individit për t’u konsideruar i pafajshëm nuk ka gjetur vetëm njohje, por edhe zbatim në nivel evropian nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, që e ka shndërruar prezumimin e pafajësisë në një element përcaktues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke krijuar një jurisprudencë të bollshme.
- Respektimi i këtij parimi është i detyrueshëm si për organet e drejtësisë, ashtu edhe për ato të administratës publike. Ky është qëndrimi konsekuent i Gjykatës Evropiane të të Drejtave

⁷ Shihni përgjigjet e subjektiv të paraqitura nga përfaqësuesi ligjor pranë Komisionit mbi rezultatet e hetimit.

të Njeriut, por edhe i Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës: *“Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza”*.

- Në përfundim të hetimit të kryer nga Prokuroria e Posaçme, subjekti i rivlerësimit është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 295/a/3 të Kodit Penal. Rezulton se nga ana e Prokurorisë së Posaçme është paraqitur kërkesa për dërgimin në gjyq të çështjes për këto vepra penale para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Rezulton se aktualisht çështja është duke u shqyrtuar nga gjyqtari i seancës paraprake.
- Referuar rastit konkret, rezulton se Komisioni e ka përfunduar hetimin administrativ kryesisht për një nga tri kriteret e rivlerësimit, dhe konkretisht në kriterin e vlerësimit të figurës, bazuar në bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç e 295/a/3 të Kodit Penal.

48. Sa më sipër, Komisioni vlerësoi qëndrimin e avokatit A. N në lidhje me barrën e provës dërguar nga Komisioni në lidhje me çështjen e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita.

49. Gjithashtu, në seancën dëgjimore të datës 4.9.2024, qëndrimi përfundimtar i avokatit A. N ishte dhe çelja e hetimit, edhe për sa i përket dy kriterëve të tjera të vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Xhevahir Lita.

50. Trupi gjykues sqaroi se kjo kërkesë ishte shqyrtuar më parë nga Komisioni dhe përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit ishte njoftuar në lidhje me refuzimin e saj⁸.

Vlerësimi i Komisionit

51. Bazuar në pikën 6 të nenit 3 të ligjit 84/2016, përcaktohet se: *“Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër”*.

52. Gjithashtu, pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përcakton se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”...”*.

53. Subjekti i rivlerësimit jo vetëm që duket se ishte në dijeni për hetimin penal ndaj shtetasit B. B., i cili akuzohej edhe për vepra penale të përfshira në krimin e organizuar, por ka ndjekur vetë më pas hetimet për këtë çështje dhe këtë subjekt, duke vazhduar të mbajë kontakte të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me qëllim favorizimin e tij dhe shmangien e përgjegjësisë në procesin penal. Pra, subjekti Xhevahir Lita jo vetëm që duket se ka pasur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por duket se ka qenë vetë pjesë e kësaj strukture, për të

⁸ Shihni vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 15.7.2024.

cilën është ngritur fillimisht akuza penale “Grup i strukturuar kriminal” dhe është marrë i pandehur, duke iu caktuar edhe masa e sigurisë personale “Arrest në burg”.

54. Gjykata e Lartë me vendimin e saj⁹ ka vendosur standarde në gjykimin e çështjeve që lidhen me ligjshmërinë e provës së mesazheve “chat” në SkyECC, duke e gjetur të drejtë përdorshmërinë e kësaj prove në procesin penal.

55. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh edhe me mënyrën e sjelljes që pritet nga një magjistrat. Me këto veprime të konstatuara duket se subjekti ka shkelur standardet e sjelljes së një magjistrati në veçanti, të cilat janë dhe duhet të jenë shumë më të larta se ato të shoqërisë në tërësi, duke treguar mungesë integriteti në zbatimin e ligjit, si dhe me sjelljen e tij personale ai ka ndikuar në të gjithë sistemin gjyqësor, duke qenë se sjellja e një magjistrati pritet të jetë një sjellje e paqortueshme, pavarësisht të gjitha rrethanave të paraqitura.

56. Pavarësisht aktakuzave, ecurisë së procesit penal dhe përgjegjësisë penale të subjektit të rivlerësimit, që po ndiqen nga SPAK dhe gjykatat shqiptare, bazuar në faktet dhe provat e administruara në këtë proces administrativ, Komisioni konkludon se:

- Subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Sjellja e subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe pasi mori në shqyrtim pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se në zbatim të nenit 61 “Shkarkimi nga detyra”, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, referuar shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁹ Vendimi nr. **** (*), datë 22.12.2023, i Gjykatës së Lartë.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Xhevahir Lita, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi